



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNËS

08 NOV 2022

M-030/01-245433/22, më

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15 qershor 2008), të nenit 13, paragrafit 1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës merr këtë

V E N D I M

- I. Miratohet Vendimi për fillimin e procedurave të konsultimit publik për Projekt Rregulloren për orarin e punës dhe mbrojtjen nga ndotja akustike në sektorin e Gastronomisë.
- II. Organizimi i konsultimit publik do të bëhet sipas Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna.
- III. Konsultimi publik sipas pikës I të këtij Vendimi do të zgjatë 30 ditë, nga dita e shpalljes së njoftimit publik për mbajtje të konsultimit.
- IV. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet zyrtari përgjegjës për koordinimin e konsultimit publik.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U DORËZOHET:

- Zyrtarit përgjegjës për koordinimin e konsultimeve publike;
- Qendrës për shërbime me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KOMUNËS
Përparim Rama

